



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670-19941 të datës 29.05.2020, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË
STUDENTËVE PËR NDARJEN E BURSAVE

Neni 1
Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të studentëve për ndarjen e bursave të cilët kanë aplikuar sipas Konkursit publik të shpalluar nga Drejtorati për Arsim me Nr.4-111-64445 i datës 19.10.2021, në përbërje si vijon:

1. Teuta Berisha, Drejtorati për Arsim, Kryesuese
2. Floranda Zeqiri, Drejtorati për Arsim, anëtare
3. Bajrush Limani, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e studentëve për ndarjen e bursave brenda afatit 15 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit publik, konform kritereve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670-19941 të datës 29.05.2020, Rregullores 15Nr.670-47372 të datës 30.09.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670-19941 të datës 29.05.2020 dhe kritereve të përcaktuara në Konkursin publik
2. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni shpallë listën preliminare në faqen zyrtare të Komunës ndërsa pas përfundimit të procedurave të ankesave Komisioni shpallë listën përfundimtare
3. Punët administrative- teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Arsim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit me kopjen e të cilit do të njoftohen DKA, Kryesuesia dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020 - 66502
Lipjan, më 27.10.21

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

